

# KUSHTE PËR ANGAZHIMIN E NJË EKSPERTI PËR VLERËSIMIN E PASURISË ME QËLLIM ZBATIMIN E DETYRAVE TË PUNËS

## Për përgatitjen e Studimit për vëzhgimin e tregut

**Titulli i projektit:** Zhvillimi i shërbimeve të biznesit për kujdesin dhe mbështetjen e integruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (KKRMV)

**Periudha e realizimit:** 15 Shkurt – 20 Qershor viti 2021

**Qëllimi i përgjithshëm i shërbimeve konsultative:** Përgatitja e dy studimeve të veçanta të realizimit për Qendrat Social-Mjekësore të qëndrueshme ekonomikisht për të moshuarit që do të jenë në funksion të ofrimit të shërbimeve nga Kryqi i Kuq i Maqedonisë së Veriut në Dojran dhe Shkup. Korrespondenca zyrtare midis porositesit dhe ekzekutuesit do të bëhet në gjuhën angleze.

### 1) Përshkrim i shkurtë i projektit

Duke filluar nga viti 2019, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë Veriore dhe Kryqi i Kuq Austriak filluan bashkëpunimin e përbashkët për një projekt që do të synojë krijimin e një Qendre Mjekësore Sociale (QMS) në Dojran dhe Shkup. Gjatë kësaj periudhe, u zhvilluan takime konsultative me Bankën Austriake të Zhvillimit dhe Bankat Kombëtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, një vizitë në Kryqin e Kuq Austriak në Maqedoninë e Veriut, një vizitë në vendin e projektit, palët e interesuar lokalë dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale të RMV, për të mbledhur informacionin e duhur për zhvillimin e mëtejshëm të projektit. KKRMV realizoi një vizitë studimore në Vjenë në Shkurt të vitit 2020, qëllimi i së cilës ishte të finalizonte konceptin për krijimin e QMS në Dojran dhe Shkup.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut është pronari i objektit në Dojran i cili planifikohet të adaptohet si një Qendër Mjekësore Sociale, përfshirë një institucion spitalor për kujdesin e grave dhe burrave të moshuar. Në këtë rajon, ende nuk ka një lloj të tillë institucioni, ka një mungesë të shërbimeve mjekësore, kështu që komuniteti lokal do të kishte një përfitim të rëndësishëm nga futja e shërbimeve të reja inovative. Aktualisht, shumica e qytetarëve të popullsisë së moshuar jetojnë në shtëpitë e tyre, pa kujdesin e duhur. Migrimi ekonomik i të rinjve është gjithashtu popullor në këtë rajon për shkak të mundësive të kufizuara të punës.

Nga kujdesi stacionar në Qendrën Mjekësore-Sociale në Dojran pritet të përfshihen 70 përfitues meshkuj dhe femra që do të përfitonin. Përveç kujdesit institucional, parashihet mbështetje në kushte shtëpiake, si dhe ndihmë në shtëpi në Dojran si dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor në vetë Qendrën Mjekësore Sociale. Shërbimet do të përcaktohen dhe janë objekt i këtij projekti, pra studimi për realizim.

Së bashku me Qendrën Sociale-Mjekësore në Dojran, është planifikuar të hulumtohet mundësia për Shkupin, si një qytet me potencialin më të madh për sukses dhe zhvillimin e shërbimeve të

Qendrës Social-Mjekësore për të moshuarit dhe të sëmurët. Gjysma e popullsisë së përgjithshme është e vendosur në kryeqytetin Shkup, i cili është gjithashtu qendra e jetës së biznesit në Maqedoninë e Veriut. Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit zotëron objektet e planifikuara në Vodno (zonë malore në Shkup) të cilat mund të përdoren për t'u shërbyer dhe mbuluar me kujdesin e duhur mjekësor nga 80 gra dhe burra përdorues.

Dotë zhvillohen studime për realizim dhe dy biznes plane për Qendra Mjekësore Sociale (QMS) në Shkup dhe Dojran, për qasje te partnerët financiarë me kushtet më të mira të huasë për krijimin e këtyre qendrave duke filluar nga viti 2021, si dhe qasje në financat e implementimit. të bizneseve të tilla sociale.

### 1) SHQYRTIMI I QËLLIMEVE:

- a) Analizë e makro mjedisit për krijimin e Qendrave Social-Mjekësore në Shkup dhe Dojran.
- b) Krijimi, koordinimi dhe kryerja e hulumtimit të tregut në rajonin Juglindor dhe Shkup.

### 2) DETAJE PËR QËLLIMET:

- a) Të bëhet një analizë e mjedisit makro për krijimin e Qendrave Social-Mjekësore në Shkup dhe Dojran.
  - b) Të dizajnohet metodologjia për vëzhgimin e tregut.
  - c) Të trajnohen intervistorët dhe moderatorët.
  - ç) Të koordinohet zbatimi i hulumtimit të tregut. Konsulenti pritët të koordinojë kërkimin e tregut, përfshirë a) nevojat specifike për shërbime në Qendrën Mjekësore Sociale; b) madhësia e tregut; c) konkurrentët; ç) modelet e çmimeve; dh) burimet e të ardhurave; e) maks. çmimi mujor për shtrat; ë) lista e burimeve të tjera të të ardhurave (p.sh. hapësira me qira, trajtimet, shërbimet mjekësore).
  - d) T'i grumbullojë të dhënat nga hulumtimi i tregut dhe t'i analizojë të dhënat.
  - dh) të zhvillojë konkluzë dhe të dorëzojë raport përfundimtar.
- Да развие заклучок и да достави конечен извештај. Konsulenti pritët të finalizojë raportin e studimit të tregut.

### 3) DORËZIMI / KORNIZA KOHORE

1. Dorëzimi: Fundi i muajit Mars
  - a) Të kryejë një analizë të mjedisit makro për krijimin e Qendrave Social-Mjekësore në Shkup dhe Dojran;
  - b) Të përgatisë pyetësin për zbatimin e intervistave;
  - v) Të takohet dhe të bisedojë me kontraktorin, si dhe të përshtatet me kërkesat e tij;
2. Dorëzimi: Fundi i muajit Maj
  - a) Të hartojë metodologjinë e hulumtimit të tregut;
  - b) Të zhvillojë një modul trajnimi, si dhe dokumentet e punës dhe sfondit;
  - c) Ta zbatojë trajnimin;
  - ç) Të koordinojë kryerjen e hulumtimit të tregut.
3. Dorëzimi: Mesi i muajit Qershor
4. a) T'i dorëzojë të dhënat e grumbulluara;
- b) Ta dorëzojë analizën e të dhënave;

- c) Analiza e hulumtimit të tregut e kryer sipas konceptit, metodologjisë dhe udhërrëfyesit;
- ç) Të dorëzojë raportin përfundimtar bazuar në të dhënat e marra nga pjesa

**4) KANDIDATËT ADEKUAT duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:**

- a) Të jetë konsulent individual, person fizik.
- b) Lejohet partneritet dhe nëngrante, në kusht që personi juridik – aplikuesi të ketë rol të rëndësishëm në zbatimin e detyrës. Aplikanti do të jetë personi i vetëm juridik me të cilin do të nënshkruhet lidhja kontratuese.
- c) Njohje akademike të biznes administratës, biznese qëndruese, marketing dhe ngjajshëm.
- ç) Komunikim i rrjedhshëm i gjuhës angleze dhe aftësi të shkëlqyeshme për të shkruar.
- d) Përvojë e lartë në kryerjen e hulumtimit të tregut, mbledhjen e të dhënave dhe analizën e të dhënave, përgatitjen e kërkimit dhe trajnimin për kryerjen e aktiviteteve kërkimore
- dh) Të ketë përvojë paraprake në punën e me organizata joqeveritare dhe ndërmarrje sociale.

**5) KANDIDATËT ADEKUAT duhet të dorëzojnë dy korniza të posaçme financiare për përgatitjen e studimeve të realizimit për Shkup dhe Dojran.**

**6) PAGESA**

Në tre pjesë, nga çmimi i përgjithshëm (MKD), pas:

- a) Nënshkrimi të marrëveshjes; (20%)
- b) Dorëzimit të analizës së lokacioneve dhe raportit për evaluimin e aspekteve juridike (30%)
- c) Dorëzim i raportit përfundimtar dhe vlerësimit financiar (50%)